



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PERGJITHSHME E TATIMEVE

Nr. 21268/1 prot /

Tiranë, më 18.11.2010

URDHER

Nr. 14, date 18.11 2010

**“Per
leshimin e vertetimeve nga
Drejtorite Rajonale Tatimore me kerkese te tatimpaguesve “**

Ne baze te Ligjit nr. 9920 date 19.05.2009 “Per Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqiperise”, i ndryshuar, (nenet 1, 10.2, 12,a,ç) ; Udhezimit te Ministrit te Financave dale ne zbatim te tij si edhe Ligjit nr. 8445 date 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” Kreu I (nenet 1, 2, 5), nisur nga vleresimi dhe ecuria e procesit te pajisjes te tatimpaguesve sipas detyrimeve ligjore me pajisje fiskale dhe me qellim rritjen e efektivitetit ne lidhje me kete proces,

U r d h ë r o j :

1. Drejtorite Rajonale Tatimore, te evidentojne te gjitha subjektet qe kane detyrimin ligjor per t'u pajisur dhe perdorur pajisje fiskale, *ne nje apo me shume se nje vendndodhje te ushtrimit te aktivitetit.*
2. Per cdo rast te kerkesave te tatimpaguesve objekt te detyrimit ligjor per pajisje dhe instalim te pajisjeve fiskale, drejtuar Drejtorive Rajonale Tatimore, per pajisje me “Vertetime” apo cdo lloj tjetër akti te kerkuar nga ana e tyre, i cili ka te beje me pasjen apo mospasjen e detyrimeve kundrejt organit tatimor, ose dokumentacion tjetër qe ka te beje me situaten financiare te tatimpaguesit, thene ndryshe “sherbime te kerkuara nga tatimpaguesi” per pajisje me akte te leshuara nga Administrata Tatimore, duhet me pare te paraqesin, dokumentacionin me ane te te cilit te vertetojne qe jane te pajisur me pajisje fiskale, te cilat jane kontrata me shoqerine e autorizuar dhe mandat pagesa.
3. Drejtorite Rajonale Tatimore nuk duhet te leshojne asnje akt qe ka te beje me situaten e tatimpaguesit, nese nuk vertetohet me dokumentacionin perkates, disponimi i pajisjes fiskale apo perfundimi i procedures per t'u pajisur me “te”, sipas kushteve te percaktuara ne ne piken 15 te V.K.M.-se nr.781 date 14.11.2007 “Per karakteristikat teknike e funksionale te pajisjeve fiskale, sistemit te integruara te

komputeruazuar per transferimet periodike, automatike, te deklarimeve financiare, sistemit te komunikimit, per proceduren e dokumentacionin per miratimin e tyre dhe per kriteret per pajisjen me autorizim, te shoqerive te autorizuar per ofrimin e pajisjeve fiskale” i ndryshuar.

4. Strukturat pergjegjese te Drejtorise Rajonale Tatimore duhet te bejne ne vijimesi azhornimin dhe evidentimin e sakte te listes se subjekteve te pajisur me pajisje fiskale, konform kushteve te percaktuara ne aktet ligjore dhe nenligjore ne fuqi
5. Drejtuesit e Drejtorive Rajonale, te marrin masat e menjehershme per njohimin me kete Urdher dhe zbatimin korrekt te tij.
6. Ne zbatim te nenit 28/2 te Ligjit nr. 9920 date 19.05.2008 “Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise”, “*informimi i publikut*”, Drejtoria e Sherbimit te tatimpaguesve te marre masat per publikimin e ketij Urdheri ne faqen zyrtare te internetit te Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve, ne adresen elektronike, <http://www.tatime.gov.al>.

Ky urdher hyn ne fuqi 5 dite kalendarike pas publikimit te tij .

Gazmir SPAHIJA

Drejtore i Pergjithshem

